



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

(1.03 - Your New Identity In Christ Jesus)

(Shkrimet nga ALBB)

1. Çfarë ndodhi kur u bërë i krishterë?

Efesianët 2:10-13

¹⁰ Ne në fakt jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to.

¹¹ Prandaj kujtohuni se **dikur ju johebrenj në mish**, të quajtur të parrethprerë nga ata që e quajnë veten të rrethprerë, sepse të tillë u bënë në mish, nga dora e njeriut,

¹² ishit **në atë kohë pa Krishtin**, të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qënë pa Perëndi në botë.

¹³ **Por tani, në Krishtin Jezus, ju që dikur ishit larg, u afruat me anë të gjakut të Krishtit.**

- Kur ti pranove Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tënd (Rom. 10:9-10) ti u “u linde nga Perëndia” dhe u rikrijove në Krishtin Jezus.
- Në botën natyrore ti u **linde nga nëna jote** – por në atë frymërore ti “**u linde nga Perëndia**” ose **u rikrijove**; në njeriun tënd frymëror (në zemrën tënde) ndodhi një ndryshim.
- Ti more “**lindjen e re**” nga fuqia krijuese e Perëndisë.

2 Korintasve 5:17

¹⁷ Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja.

- Fryma e Shenjtë rrinte mbi ty, gati për të realizuar Fjalën e Perëndisë në ty kur ti pranove Jezusin si Zot – pikërisht si tek libri i Zanafillës, kapitulli 1.
- **Njeriu i vjetër** – njeriu yt frymëror i paripërtërirë – u **zëvendësua nga njeriu i ri**.
- Ti kalove **nga vdekja frymërore** (ndarja nga jeta e Perëndisë) **tek jeta frymërore** në Perëndinë, ose ti u lidhe me jetën e Perëndisë .
- **Natyra jote e vjetër mëkatare vdiq** dhe po ashtu edhe **fuqia e mëkatit** mbi ty.
- **Perëndia** të fali ty dhe të gjithë të kaluarën tënde – Ai **i fali** dhe i **harroi** mëkatet e tua.
- **Dëshirat e vjetra** të mishit (natyra e vjetër) kaluan – **dëshira të reja** erdhën nga Perëndia dhe gjërat e Perëndisë.

Galatasve 5:16-21

¹⁶ Dhe unë them: Ecnj sipas Frymës dhe nuk do ta përmbushni dëshirat e mishit,

¹⁷ sepse mishi ka dëshira kundër Frymës, dhe Fryma ka dëshira kundër mishit; dhe këto janë të kundërta me njëra-tjetrën, që ju të mos bëni ato që dëshironi.

¹⁸ Por në qoftë se udhëhiqeni nga Fryma, ju nuk jeni nën ligj.

¹⁹ Dhe **veprat e mishit janë të zbuluar** dhe janë: kurorëshkelja, kurvëria, ndyrësia, shthurja,

²⁰ idhujtaria, magjia, armiqësimi, grindjet, xhelozitë, meritë, zënkat, përçarjet, tarafet,

²¹ smira, vrasjet, të dehurit, grykësia dhe gjëra të ngjashme me këto, për të cilat po ju paralajmëroj, si kurse ju thashë edhe më parë, se ata që i bëjnë këto gjëra nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë.

- Ti u bërë një “**lloj specije**” e re që nuk ka ekzistuar kurrë më parë.

2. Kuptimi dhe realiteti i të qenit në Krishtin

Kur ti e kupton se kush je në Krishtin Jezus, mendimet e tua, atë që ti beson, e folura jote dhe veprimet e tua do të ndikohen në një nivel tërësisht të ri.



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

2.1 Kur je në Krishtin Jezus?

Efes. 2:13.

¹³ Por tani, në Krishtin Jezus, ju që dikur ishit larg, u afruat me anë të gjakut të Krishtit.

- **Tani!** Kur ti pranove Jezusin në jetën tënde.

2.2 Kush është në Krishtin Jezus?

Efes. 1:10.

¹⁰ Që, kur të plotësoheshin kohërat, t'i sillte në një krye të vetëm, në Krishtin, **të gjitha gjërat**, ato që janë **në qiejt** dhe ato që janë **mbi dhe** – në Të.

- **Njerëzit në qiell dhe tokë!**

2.3 Në Krishtin ti je:

- **"I shpëtuar"** – Pse? Sepse ti e rrëfeve Jezusin si Zotin tënd!

Rom. 10:9-10

⁹ Sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, **do të shpëtohesh.**

¹⁰ Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim.

2.4 Në Krishtin ti je:

- **"I shëruar"** – Pse? Sepse Jezusi vajti në kryq dhe mori vetë mallkimin e ligjit dhe shkatërroi (Vep. 10:38) fuqinë e sëmundjes dhe nga vurratat e Tij ne jemi shëruar!

Isaia 53:4, 5

⁴ Megjithatë ai **mbante SËMUNDJET** tona dhe **kishte marrë përsipër DHIMBJET** tona; por ne e konsideronim të goditur, të rrahur nga Perëndia dhe të përulur.

⁵ Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe **për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar.**

Mateu 8:17

¹⁷ Që kështu të përmbushej fjala e profetit Isaia kur tha: **"Ai i mori lëngatat tona dhe i mbarti sëmundjet tona"**.

1 Pjetrit 2:24

²⁴ Ai vet i barti mëkatet tona në trupin e tij mbi drurin e kryqit që ne, të vdekur për mëkate, të rrojmë për drejtësi; **dhe me vurratat e tij ju u shëruat.**

2.5 Në Krishtin ti je:

- **"I çliruar"** – Pse?

Kol. 1:13

¹³ Ai **na nxori** [ose çliroi] nga **pushteti i errësirës** dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur.

Luka 4:18

..... për të çliruar të shtypurit,....



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

2.6 Në Krishtin ti je:

- **“Ke Perëndinë brenda teje”** – Pse? Jezusi kishte Atin në Të dhe nëse ti je në Krishtin, atëherë edhe Ati është në ty!

Gjoni 14:10

¹⁰ A nuk beson se unë jam në Atin dhe se Ati është në mua? Fjalët që po ju them, nuk i them nga vetja. **Ati që qëndron në mua, është ai që i bën veprat.**

2.7 Në Krishtin ti je:

- **“Bashkëtrashëgimtar”** – Pse? Ti u bërë një frymë me Të, ti je në Të dhe Ai është në ty, sepse ti e pranove Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar.

Gjoni 15:7

⁷ **Në qoftë se qëndroni në mua dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkoni çfarë të doni dhe do t’ju bëhet.**

2.8 Në Krishtin ti je:

- **“I shenjtë dhe pa njolla”** – Pse?

Efes. 1:4

⁴ Sikurse na zgjodhi në të përpara se të themelohej bota, që të jemi **të shenjtë dhe të papërlyer** përpara tij në dashuri.

- Ti nuk je më një mëkatar i vjetër i shpëtuar nga hiri – nuk mund të jesh të dyja.
- Ti je drejtësia e Perëndisë në Krishtin Jezus.
- Perëndia të ka pranuar sepse ti je në Birin e Tij – ti i përket Atij.
- Zgjohu për drejtësinë dhe mos mëkato - 1 Kor. 15:34.
- Mëkati nuk ka pushtet mbi ty si një besimtar i rilindur – Jakobi 4:7.

3. Në Krishtin ti ke marrë një trashëgimi

3.1 Fjala do të të japë ty trashëgiminë tënde!

Veprat e Apostujve 20:32

³² “Dhe tani, o vëllezër, unë po ju lë te Perëndia dhe te **fjala** e hirit të tij, që është në gjendje t’ju ndërtojë dhe t’ju japë trashëgiminë në mes të të gjithë të shenjtëruarve.

- Çfarë të përket ty në Krishtin?
- Çdo shkrim që i referohet të qenit **“në Krishtin,” “në Të,”** ose **“në të Cilin.”**

3.2 Kur do ta marrësh trashëgiminë tënde? E ke tashmë!

Efes.1:11

¹¹ Në të edhe kemi qenë zgjedhur [**kemi marrë**] për një trashëgimi, duke qenë të paracaktuar sipas vendimit të atij që vepron të gjitha sipas këshillës së vullnetit të tij,

- **Kemi marrë – koha e shkuar!**



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

3.3 Ti ke hyrë në trashëgiminë tënde në Të, tani këtu mbi tokë – ti ke të drejtë të veprosh në këtë trashëgimi sot.

Kol. 1:12-14

¹⁴ duke e falënderuar Perëndinë At, **që na bëri të denjë të kemi pjesë trashëgimin e shenjtoreve në dritë.**

¹³ Ai na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur,

¹⁴ në të cilën ne kemi shpengimin me anë të gjakut të tij dhe faljen e mëkateve.

- Ne **jemi bërë bashkëpjesëtarë** në trashëgiminë e Tij!

3.4 Çfarë ke trashëguar në Të? – Parajsën dhe shumë më shumë!

Heb. 1:4

⁴ Edhe aq më i lartë u bë se engjëjt, **sa më i shquar se ata është emri që ai e trashëgoi.**

- Ti e ke **trashëguar autoritetin e Jezusit** dhe emrin e Tij.

Kol. 2:9-10

⁹ Sepse tek ai banon trupërisht gjithë plotësia e Hyjnisë.

¹⁰ Dhe **ju keni marrë plotësinë në të, sepse ai është krye e çdo principate e pushteti.**

- Ti ke trashëguar mbretërinë e Perëndisë.
- **Në ty është mishëruar natyra e Perëndishme** – Jezusi, Fryma e Perëndisë, Ati qiellor, mendja e Krishtit, besimi i Perëndisë, dashuria e Perëndisë.

3.5 Çdo gjë që mori Jezusi kur u ringjall nga vdekja, dhe çdo gjë që i ka ndodhur Jezusit qëkurse u ringjall nga vdekja, është e jotja, jo vetëm një pjesë e saj, por e gjitha!

- Jezusi **mori një trup të përlëvdur** pasi u ringjall nga të vdekurit, dhe kështu do jetë edhe me ty.
- Jezusi **është ulur në të djathtë të Atit** në vendet qiellore, dhe kështu edhe ti në Të dhe nëpërmjet Tij.

3.6 Trashëgimia jote të shpengon krejtësisht nga mallkimi i ligjit.

Gal. 3:13-14

¹³ Krishti **na shpengoi nga mallkimi i ligjit, sepse u bë mallkim për ne (duke qenë se është shkruar: “I mallkuar është kushdo që varet në dru”),**

¹⁴ që bekimi i Abrahamit t’u vijë johebrenjve me anë të Jezu Krishtit, që ne të marrim premtimin e Frymës me anë të besimit.

Gal. 3:29

²⁹ Dhe, në qoftë se jeni të Krishtit, jeni pra pasardhja e Abrahamit dhe **trashëgimtarë sipas premtimit.**

- Perëndia ka lëshuar tashmë në jetën tënde të gjitha bekimet që mund të na ofrojë qielli. Ato janë tashmë të tuat. Por **Perëndia nuk do të t’i imponojë**. Ti duhet të pranosh trashëgiminë tënde në Krishtin Jezus dhe ta lejosh të jetë pjesë e jetës tënde, para se të jesh në gjendje të ecësh në të. Ti je **shpenguar nga “mallkimi” dhe tani ke ardhur tek “bekimet” – (LiP. 28).**



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

4. Pozicioni yt i ri në Krishtin nga pikëpamja e drejtësisë

4.1 Ti je drejtësia e Perëndisë në Krishtin Jezus.

2 Korintasve 5:17-21

¹⁷ Prandaj nëse dikush është në Krishtin, **ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja.**

¹⁸ Edhe të gjitha gjërat janë nga Perëndia që na pajtoi me veten përmes Jezu Krishtit dhe na dha shërbimin e pajtimit,

¹⁹ sepse Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin, duke mos ua numëruar njerëzve fajet e tyre dhe vuri ndër ne fjalën e paqimit.

²⁰ Ne, pra, **bëhemi lajmëtarë për Krishtin**, sikurse Perëndia të këshillonte nëpërmjet nesh; dhe ne ju këshillojmë juve për hir të Krishtit: Paqtohuni me Perëndinë!

²¹ Sepse ai bëri të jetë mëkat për ne ai që nuk njihete mëkat, **që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të.**

4.2 Të jesh në Krishtin Jezus të bën ty një krijesë ose krijim të ri, por mendja jote duhet të ripërtërihet, në mënyrë që të kontrollosh veprat e mishit! Kjo është përgjegjësia jote:

- Të ushqejmë shpirtin tonë dhe të maturohemi në frymën e Perëndisë.
- Të rinovojmë mendjen tonë – nëpërmjet Fjalës.

Rom. 12:2

² Dhe mos u konformoni me këtë botë, por **transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj**, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullnet i Perëndisë.

- Të marrim në kontroll ose të disiplinojmë mishin dhe dëshirat tona.

Efes. 4:20-24

²⁰ Por ju nuk e keni njohur kështu Krishtin,

²¹ në qoftë se e keni dëgjuar atë dhe keni qënë të mësuar në të sipas së vërtetës që është në Jezusin, ²² që të zhvisheni, për sa i takon sjelljes së mëparshme, nga njeriu i vjetër që

korruptohet me anë të lakmive të gënjeshtërës, ²³ **dhe të përtëriteni në frymën e mendjes suaj**

²⁴ dhe të visheni me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësinë dhe shenjtërinë e së vërtetës.

4.3 Thjesht të dish që je drejtësuar nuk mjafton dhe shumë besimtarë janë duke jetuar shumë më poshtë se pozicioni i tyre i drejtësisë!

- Kuptimi i drejtësisë – fjalë për fjalë do të thotë **të qëndrosh drejt** me Perëndinë.
- Të jesh i vendosur në këtë **pozitë i jep një fëmijë të Perëndisë të drejta dhe privilegje..**
- Drejtësia (**ajo që ti je**) nuk është shenjtëri (e cila është sjellja jote).
- **Besimi të ka sjellë në një pozicion** drejtësie.
- **Ti tani je një qytetar i qiellit** duke qënë **“i lindur sërish”** në Krishtin Jezus.
- Shembull: **të qënit qytetar i një shteti, të jep të drejta të caktuara – Amerika ka “Deklaratën e të Drejtave”.**
- E njëta gjë është edhe me një fëmijë të Perëndisë – të jesh një besimtar në Krishtin të jep të drejtën e çdo gjëje që është e Mbretërisë – **Bibla është “deklarata jote e të drejtave” në Mbretërinë e Perëndisë!**



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

4.4 Një histori – të krishterët që jetojnë më poshtë se të drejtat e tyre në Mbretërinë e Perëndisë.

Një burrë, që kishte humbur gjithçka, edhe shtëpinë dhe paratë, u gjet në rrugë duke lypur para dhe duke u përpjekur që të gjente ushqim ku të mundte. Ky burrë kishte humbur çdo gjë...madje edhe gjenealogjinë dhe prejardhjen e familjes së tij. Ky burrë nuk e dinte që dikush kishte vdekur dhe që i kishte lënë një trashëgimi që përfshinte një titull mbretëror dhe pasuri. Kjo e bëri atë shumë të pasur dhe kjo do të thoshte që atij nuk do t'i duhej më të rrinte rrugëve të lypte për mëshirë nga bota. Kur më në fund i treguan për pasurinë e tij të madhe, ai nuk e besoi që ishte i pasur dhe që kishte një titull mbretëror, sepse besonte vetëm atë që shikonte me sy dhe rrethanat në të cilat jetonte. Ky burrë, edhe pse ishte i pasur dhe nga një familje mbretërore, mbeti në varfëri dhe jetoi një jetë të mjerë, shumë më poshtë se jeta dhe trashëgimia që i ishte lënë.

Shumë të krishterë (besimtarë të rilindur) janë duke jetuar shumë më poshtë se më e mira e Perëndisë. Ata nuk i dinë kushtet (të drejtat e tyre) të kontratës, të besëlidhjes së tyre, të Dhiatës së Re.

4.5 Armatimi i Perëndisë të jep drejtësimin

- Pjesë e armatimit të Perëndisë është **parzmorja e drejtësisë** tek Efesianët 6:10-18 – e cila mbulon pjesët e rëndësishme të trupit të një ushtari.
- **Drejtësia jote** me Perëndinë shërben si një parzmore – ajo mbulon pjesët më të rëndësishme të identitetit të një krishteri – **të drejtën e tij për autoritetin** që i është dhënë atij në Jezus Krishtin.
- Të kesh veshur parzmoren do të **futë në fuqi forcën e drejtësimin** për ty.
- Për shkak të pozicionit tënd, ti mund të presësh këto gjëra:

1 Pjet. 3:12

¹² *Sepse sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e tij janë në lutjen e tyre; por fytyra e Zotit është kundër atyre që bëjnë të keqen*

Jakobi 5:16

¹⁶ *Rrëfeni fajet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin, që të shëroheni; shumë fuqi ka lutja e të drejtit kur bëhet me gjithë shpirt.*

5. Pozicioni yt i ri në Krishtin nga qëndrimi i autoritetit

Një prej gjërave më të vështira për një të krishterë është të veprojë dhe të jetojë në qëndrimin e autoritetit (në dhe nëpërmjet Krishtit Jezus) – dhe jo si një mi kishe i ndrojtur!!!!

5.1 Kur ti e bërë Krishtin Jezus Zotin e jetës tënde:

- Ti u çlirove nga **fuqia** e errësirës – fjala **fuqi** fjalë për fjalë përkthehet **autoritet** – Kolosianëve 1:13.
- Ti je **çliuar nga fuqia dhe autoriteti i errësirës** dhe je vendosur në Mbretërinë e Perëndisë – e cila i përfshin të dyja, edhe qiellin edhe tokën – Mateu 28:18-19.
- **Fuqia të është dhënë si një pjesë e trashëgimisë tënde** në Jezusin sepse ti je në Të dhe Ai është në ty!
- Rom. 5:18 thotë që drejtësia ka ardhur mbi të gjithë njerëzit, por jo të gjithë njerëzit janë bërë të drejtë, sepse jo të gjithë njerëzit **e kanë përdorur autoritetin e tyre si qenie njerëzore. Që të marrësh drejtësimin ti duhet të vepros në të nga pikëpamja e autoritetit.**



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

2 Korintasve 5:21

²¹ Sepse ai bëri të jetë mëkat për ne ai që nuk njihte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të.

- Duke qenë se ti je në Jezusin, **Perëndia të shikon në të njëjtën mënyrë që Ai shikon Jezusin** dhe Ai do që të të trajtojë në të njëjtën mënyrë që trajton Jezusin!

Hebrenjtë 1:3

³ Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së tij dhe vula e qenies së tij dhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së tij, mbasi e bëri vetë pastrimin nga mëkatet tona, u ul në të djathtën e Madhërisë në vendet e larta.

- **Fuqia e Perëndisë është në Fjalën e Tij.** Ai është duke i mbajtur të gjitha gjërat me fuqinë e fjalës së Tij.
- **Një "besimtar" duhet të mësojë të shërbejë në të njëjtin autoritet siç bëri Jezusi në shërbesën e Tij tokësore** dhe edhe si apostujt në librin e Veprave të Apostujve, mbi fuqinë dhe veprat e errësirës!
- **Mendo si mendon Perëndia dhe ec dhe fol në autoritetin që të është dhënë në trashëgiminë tënde.**
- **Satani do që ti të harrosh qëndrimin tënd të autoritetit – pse?** – sepse kur ti vepron nga qëndrimi dhe autoriteti që të është dhënë nga Perëndia, ai është i mundur!

6. Ti ke mendjen e Krishtit brenda teje

6.1 Krishti i përlulur dhe i përlëvduar

Filipianët 2:5-6

⁵ **Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin,**

⁶ **i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë.**

- Ti duhet **të mendosh siç mendoi Jezusi** – Ai nuk mendonte se ishte vjedhje të ishte i barabartë me Perëndinë.

Filipianëve 2:8

⁸ **Dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përluli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit.**

- Ti duhet të **përlësh veten** nën dorën e fuqishme të Perëndisë, **duke mbajtur njëkohësisht parasysh që je një bashkëtrashëgimtar me Jezusin;**

1 Pjetrit 5:6

⁶ **Përluni, pra, nën dorën e fuqishme të Perëndisë, që ai t'ju lartësojë në kohën e duhur.**

Romakët 8:17

¹⁷ **Dhe nëse jemi bij, jemi dhe trashëgimtarë, trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë të Krishtit, nëse vuajmë me të dhe lavdohemi me të.**



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

7. Mbretër dhe priftërinj

7.1 Ne jemi bërë mbretër dhe priftërinj nëpërmjet Krishtin Jezus!

Romakët 8:29

²⁹ Sepse ata që ai i ka njohur që më parë, edhe i ka paracaktuar që të jenë të ngjashëm me shëmbëlltyrën e Birit të tij, kështu që ai të jetë i parëlinduri në mes të shumë vëllezërve.

- Jezusi nuk është më Biri i vetëmlindur i Perëndisë – por i parëlinduri në mes të shumë bijve (dhe bijave) të Perëndisë.

Zbulesa 1:5-6

⁵ dhe nga Jezu Krishti, dëshmitari besnik, i parëlinduri prej së vdekurish dhe Princ i mbretërve të dheut.

⁶ Atij që na deshi dhe na lau nga mëkatet tona në gjakun e tij, dhe **na bëri mbretër dhe priftër për Perëndinë dhe Atin e tij**, atij i qoftë lavdi dhe pushtet në shekuj të shekujve. Amen.

- Ne jemi bërë **mbretër dhe priftërinj** në Perëndinë nëpërmjet Jezusit dhe trashëgimisë tonë.

1 Pjetrit 2:9

⁹ Por ju jeni fis i zgjedhur, priftëri mbretëror, një komb i shenjtë, një popull i fituar, që të shpallni mrekullitë e atij që ju thirri nga terri në dritën e tij të mrekullueshme;

- Jezusi ishte i parëlinduri, kështu që duhet të ketë një që lind më pas e kështu me radhë..!

Luka 12:31-32

³¹ Kërkoni më parë mbretërinë e Perëndisë dhe të gjitha këto do t'ju jepen si shtesë.

³² Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu t'ju japë mbretërinë.

- Është **vullneti i Perëndisë të të japë të gjithë Mbretërinë**. Ky realitet duhet të futet thellë në zemrat tona!
- Ndërkohë **që kërkon mbretërinë në radhë të parë** më pas, të gjitha të mirat e trashëgimisë tënde do të shtohen dhe ti do të rritesh dhe do të zhvillohesh në Fjalën e Perëndisë.
- E megjithatë, ti nuk do të marrësh asnjëherë ndonjë pjesë të trashëgimisë tënde, **derisa të fillosh ta pranosh atë: me mendimet e tua, me fjalët dhe veprat e tua!!!**

8. Shpalle Fjalën e Perëndisë mbi veten tënde – vazhdimisht!

Rom. 10:17

¹⁷ Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë.,

- Ndërsa rrëfen Fjalën e Perëndisë (premtimet e Perëndisë) mbi veten tënde, se kush dhe çfarë je në Krishtin jesus, **ti do të bëhesh ajo që rrëfen dhe imazhi i brendshëm** i atij që je në Krishtin ndërtohen në “njeriun tënd frymëror” përbrenda teje, dhe më pas do të bëhet realiteti edhe në të jashtmen.
- Jezusi tha që ju do bëni vepra më të mëdha se të miat, **por kjo do të ndodhë vetëm kur të pranosh kush je dhe çfarë je ti në Krishtin** dhe autoritetin tënd në Krishtin.

Gjoni 14:12

¹² Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: kush beson në mua **do të bëjë edhe ai veprat që bëj unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, sepse unë po shkoj tek Ati.**

2 Korintasve 5:17

¹⁷ Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është **një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar.**



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

9. Shpallje se çfarë thotë Fjala e Perëndisë për identitetin tënd të ri!

9.1 Në Krishtin unë jam....

* FËMIJË I PERËNDISË, I LINDUR SËRISH NGA FARA E PERËNDISË QË NUK PRISHET DHE QË JETON PËRGJITHMONË	1 Pje. 1:23
* I FALUR NGA TË GJITHA MËKATET E MIA DHE I LARË NË GJAK.....	Heb. 9:14, Kol. 1:14, Efes.1:7, 1 Gjon. 1:9, 2:12
* NJË KRIJESË E RE	2 Kor. 5:17
* TEMPULLI I FRYMËS SË SHENJTË	1 Kor. 6:19
* I ÇLIRUAR NGA FUQITË E ERRËSIRËS DHE I VENDOSUR NË MBRETËRINË E PERËNDISË.	Kol. 1:13
* I ÇLIRUAR NGA MALLKIMI I LIGJIT	1 Pjet. 1:18-19, Gal. 3:13
* I BEKUAR	LiP. 28:1-14, Gal.3:9
* NJË SHENJTOR	Rom. 1:7, 1 Kor.1:2, Fil. 1:1
* KOKA DHE JO BISHTI	LiP. 28:13
* LART DHE JO POSHTË	LiP. 28:13
* I SHENJTË DHE PA NJOLLA PARA TIJ NË DASHURI	1 Pjet. 1:16, Efes. 1:4
* I ZGJEDHUR	Kol. 3:12, Rom. 8:33
* I VENDOSUR DERI NË FUND	1 Kor. 1:8, Efes. 2:13
* FITIMTAR	Zbul. 21:7
* I ÇLIRUAR	Gjoni 8:31-33
* I FORTË NË ZOTIN	Efes. 6:10
* I VDEKUR PËR MËKATIN	Rom. 6:2, 11, 1 Pjet. 2:24
* MË SHUMË SE NGADHËNJYES	Rom. 8:37
* BASHKËTRASHËGIMTAR ME KRISHTIN JEZUS	Rom. 8:17
* I VULOSUR ME FRYMËN E SHENJTË TË PREMTIMIT	Efes. 1:13
* NË KRISHTIN JEZUS NGA VEPRA E TIJ	1 Kor. 1:30
* I PRANUAR NGA TË DASHURIT	Efes. 1:6
* I PLOTË NË TË	Kol. 2:10
* I KRYQËZUAR ME KRISHTIN	Efes. 2:5
* I GJALLË NË KRISHTIN	Efes. 2:5
* I LIRË NGA DËNIMI	Rom. 8:1
* I PAJTUAR ME PERËNDINË	2 Kor. 5:18
* I KUALIFIKUAR PËR TË PATUR PJESË NË TRASHËGIMINË E TIJ	Kol. 1:2
* I RRËNJOSUR MIRË, I NDËRTUAR, I THEMELUAR NË BESIMIN TIM, DHE PLOT ME MIRËNJOHJE	Kol. 2:7
* I RRETHPRERË ME RRETHPREJE TË BËRË JO NGA DUART	Kol. 2:11
* NJË BASHKËQYTETAR ME SHENJTORËT DHE ME FAMILJEN E PERËNDISË	Efes. 2:19
* I NDËRTUAR MBI THEMELIN E APOSTUJVE DHE TË PROFETËVE, KU JEZUSI ËSHTË GURI I QOSHES	Efes. 2:20
* I LINDUR NGA PERËNDIA DHE I LIGU NUK MË PREK	1 Gjon. 5:18
* NDJEKËSI I TIJ BESNIK	Zbul. 17:14b, Efes. 5:1
* I MBULUAR ME BEKIME	LiP. 28:2, Efes. 1:3
* DISHEPULL I TIJ SEPSE KAM DASHURI PËR TË TJERËT	Gjoni 13:34-35
* DRITA E BOTËS	Mat. 5:14
* KRIPA E TOKËS	Mat. 5:13
* DREJTËSIA E PERËNDISË	2 Kor. 5:21, 1 Pjet. 2:24
* NJË PJESËTAR I NATYRËS SË TIJ HYJNORE	2 Pjet. 1:4
* I THIRRUR NGA PERËNDIA	Tim. 1:9
* FRYTI I PARË I KRIJESËS SË TIJ	Jakobi 1:18
* I ZGJEDHUR NGA PERËNDIA	1 Thes. 1:4, Efes. 1:4, 1 Pjet. 2:9
* NJË AMBASADOR PËR KRISHTIN	2 Kor. 5:20
* VEPRA E PERËNDISË E KRIJUAR PËR VEPRA TË MIRA NË KRISHTIN JEZUS	Efes. 2:10
* BEBJA E SYRIT TË ATIT TIM	LiP. 32:10, Ps. 17:8
* I SHËRUAR NGA VURRATAT E JEZUSIT	Isa. 53:5, Mat .8:17, 1 Pjet. 2:24
* I NDRYSHUAR SIPAS IMAZHIT TË TIJ	Kor. 3:18, Fil. 1:6
* TRIM SI NJË LUAN	Fj. e Urta 28:1



1.03 - Identiteti yt i ri në Krishtin

9.2 Në Krishtin unë kam...

* MENDJEN E KRISHTIT	Fil. 2:5, 1 Kor. 2:16
* MARRË TRASHËGIMINË	Gal. 3:29, Efes. 1:11
* HYRJE NËPËRMJET NJË FRYME PËR TEK ATI	Heb. 4:16, Efes. 2:18
* FITUAR MBI BOTËN	1 Gjon. 5:4-5
* JETË TË PËRJETSHME DHE NUK DO TË DËNOHEM	Gjoni 5:24, Gjoni 6:47
* PAQEN E PERËNDISË QË IA TEJKALON ÇDO URTËSIE	Fil. 4:7
* MARRË FUQI, FUQINË E FRYMËS SË SHENJTË, FUQI PËR TË VENDOSUR DUART MBI TË SËMURËT DHE T'I SHIKOJ ATA TË SHËROHEN; FUQI PËR TË DËBUAR DEMONËT, AUTORITET MBI TË GJITHA PUSHTETET E ARMIKUT DHE ASNJË GJË NUK DO TË MË DËMTOJË. PERËNDIA NUK MË KA DHËNË NJË FRYMË FRIKE, POR FUQIE, DASHURIE DHE MENDJEJE TË SHËNDOSHË	Mat. 28:18-19, Luka 10:17-19, Mar. 6:17-18, 2 Tim. 1:7
* JETËN TIME TË FSHEHUR NË KRISHTIN ME PERËNDINË	Kol. 3:3
* TË GJITHA GJËRAT JANË TË MUNDURA PËR MUA SEPSE AI QË ËSHTË NË MUA ËSHTË MË I MADH SE AI QË ËSHTË NË BOTË	1 Gjon. 4:4, Mar. 9:23

9.3 Në Krishtin...

* UNË JETOJ NGA LIGJI I FRYMËS NË KRISHTIN JEZUS	Rom. 8:2
* UNË ECI NË KRISHTIN JEZUS	Kol. 2:6
* UNË MUND TË BËJ ÇDO GJË NË KRISHTIN JEZUS	Fil. 4:13
* UNË DO TË BËJ VEPRA MË TË MËDHA SE KRISHTI JEZUS	Gjoni 14:12
* UNË SYNOJ ÇMIMIN E THIRRJES SË LARTË TË PERËNDISË	Fil. 3:14
* UNË GJITHMONË TRIUMFOJ NË KRISHTIN	2 Kor. 2:14
* UNË SHPALL LËVDIMET E TIJ	1 Pjet. 2:9
* UNË JAM LARTËSUAR ME KRISHTIN DHE JAM ULUR NË VENDET QIELLORE	Kol. 2:12, Efes. 2:6
* UNË JAM I DASHUR NGA PERËNDIA	Kol. 3:12, Rom. 1:7, 1 Thes. 1:4
* UNË NUK SHTYHEM NGA AJO QË SHOH, DËGJOJ OSE NDJEJ, POR LËVIZ NGA FJALA E PERËNDISË	2 Kor. 5:7
* UNË E PARAQES TRUPIN TIM SI NJË SAKRIFICË TË GJALLË DHE TË PRANUESHME PËR PERËNDINË	Rom. 12:1
* UNË NUK JAM KONFORMUAR ME KËTË BOTË, POR JAM TRANSFORMUAR SIPAS IMAZHIT TË PERËNDISË NGA RIPËRTËRITJA E MENDJES. MENDJA IME ËSHTË RIPËRTËRIRË NGA FJALA E PERËNDISË DHE NGA LARJA E UJIT TË FJALËS	Rom. 12:2, Efes. 5:26
* UNË GËZOHEM NË SHPRESË, KAM DURIM NË VËSHTIRËSI, DHE JAM VIGJILENT NË LUTJE	Rom. 12:12
* NË FILLIM DO TË KËRKOJ MBRETËRINË E PERËNDISË DHE DREJTËSINË E TIJ DHE TË GJITHA KËTO GJËRA DO TË MË SHTOHEM	Mat. 6:33
* UNË JAM I PLOTËSUAR NË KRISHTIN JEZUS	Gjoni 17:21-23
* UNË NUK KAM TURP NGA UNGJILLI I KRISHTIT: SEPSE AI ËSHTË FUQIA E PERËNDISË PËR SHPËTIMIN E CILITDO QË BESON	Rom. 1:16-17
* UNË E JAP TË DHJETËN DHE PERËNDIA MË KA BEKUAR MË SHUMË SE Ç'MUND TË MBAJ; DJALL, TI JE I MUNDUR DHE NUK DO TË MË SHKATËRROSH FRYTIN E DUARVE TË MIA	Mal. 3:10-11
* UNË DO TË KEM MBARËSI DHE SHËNDET, ASHTU SIÇ KA MBARËSI EDHE SHPIRTI IM	3 Gjon. 1:2
* UNË KAM DHEMBSHURI DHE DASHURI PËR TË GJITHË NJERËZIT, SEPSE DASHURIA E PERËNDISË ËSHTË DERDHUR ME BOLLËK NË ZEMRËN TIME	1 Gjon. 4:11-12, 1 Pje. 3:8, Rom. 5:5
* UNË DO TË GËZOHEM DHE NGAZËLLOHEM GJITHMONË! SEPSE GËZIMI I PERËNDISË ËSHTË FORCA IME DHE ZOTI ËSHTË FORCA E JETËS TIME.	Neh. 8:10, Psa. 27:1, 1 Thes. 5:16
* UNË DO TË EC PËRPARA PA FRIKË.	Joz. 1:5-9
* UNË DO TË BEKOJ TË AFËRMIN TIM DHE NUK DO TA MALLKOJ.	Mat. 5:44, Luka 6:28
* UNË DO TË MEDITOJ MBI FJALËN E PERËNDISË.	Fil. 4:8, Joz. 1:8
* UNË DO TË LUTEM PA PUSHIM.	1 Thes. 5:17
* UNË DO TË DREJTOHEM NGA FRYMA E SHENJTË DHE JO NGA EMOCIONET E MIA.	Rom. 8:14
* SEPSE JAM I BINDUR QË AS VDEKJA AS JETA, AS ENGJËJT, AS PUSHTETET, AS FUQIA DHE AS GJËRAT E TASHME AS GJËRAT E ARDHSHME, AS LARTËSITË, AS THELLËSITË, AS NDOJË TJETËR KRIJESË NUK DO TË MUND TË NA NDAJË NGA DASHURIA E PERËNDISË QË ËSHTË NË Jezu KRISHTIN ZOTIN TONË	Rom. 8:38
* SEPSE JAM PLOTËSISHT I BINDUR QË PERËNDIA ËSHTË I FUQISHËM TË BËJË ATË QË KA PREMTUAR	Rom. 4:21
* JEZUSI I THA ATIJ, NËSE TI BESON, ÇDO GJË ËSHTË E MUNDUR PËR ATË QË BESON	Mar. 9:23, 10:27
* DHE JEZUSI, DUKE I PARË THA, PËR NJERIUN ËSHTË E PAMUNDUR POR JO PËR PERËNDINË: SEPSE ME PERËNDINË ÇDO GJË ËSHTË E MUNDUR	Mar. 10:27

JEZUSI ËSHTË ZOT!